

# STATUT - AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “2L NDERTIM”

Sot më datën 20.01.2023 me cilësinë e 2 (dy) ortakëve Themelues ne :

- 1- **ROLAND HYSA**, i datëlindjes 22.01.1980 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë me shtetësi shqiptare, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës letërnjoftimi nr. **038204427** dhe nr. personal **I00122104V** me vullnet të lirë e të plotë.
- 2- **ELONA BOCE**, e datëlindjes 26.05.1984 lindur në Gjirokastrë dhe banuese në Tiranë madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse letërnjoftimi nr. **035471231** dhe nr. personal **I45526074S** të cilët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, mbështetur në:

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi: Në Ligjin 9901 dt. 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare” më datën 20.01.2023 kemi themeluar një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin : “2L NDERTIM” sh.p.k (më poshtë e quajtur “Shoqëria).

## Neni 1 Emri

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “2L NDERTIM” sh.p.k. Ndryshimi i emrit të shoqërisë do të bëhet vetëm me vendim të asamblese së ortakëve.

## Neni 2 Forma Juridike dhe Përgjegjësia

Shoqëria “2L NDERTIM” sh.p.k është person juridik i të drejtës tregtare shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur Shoqëria).

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “2L NDERTIM” sh.p.k është një shoqëri që kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga 2 (dy) ortakë të cilët përballojnë humbjen deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara prej tyre.

## Neni 3 Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Rruga Rruga “Dervish Hekali” Pallati 104 Shkalla 2 Ap 14 Tiranë Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektornik është : [landhysa\\_2006@hotmail.com](mailto:landhysa_2006@hotmail.com) . Ndryshimi dhe shtimi i adresave të shoqërisë do të bëhet vetëm me vendim të asamblese së ortakëve.

## Neni 4 Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë do të jete me nje afat te pacaktuar. Ndryshimi i afatit dhe/ose crregjistrimi do të bëhet vetëm me vendim të asamblese së ortakëve.

## **Neni 5**

### **Vula**

Shoqëria ka vulën e saj, në brendësi të së cilës shkruhet i plotë emri i Shoqërisë "2L NDERTIM" SH.P.K, TIRANË.

## **Neni 6**

### **Objekti**

Punime te pergjithshme ne ndertim si me poshte: punime germimi ne toke, ndertime civile dhe industriale, rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada, punime nentokesore, ura e vepra arti, diga dhe tunele hidroteknike, ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime, punime te inxhinierise se mjedisit, rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, ndertime per nenstacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TN te mesem dhe te larte dhe shperndarje te energjise, ndertim i impianteve per prodhimin e energjise elektrike, ndertim i impianteve fotovoltaike. Punime speciale ndertimi, si me poshte: punime per prishjen e ndertimeve, punime strukture speciale: shtresa dhe mbistruktura speciale, impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtje e tyre, impiante ngritese dhe transportuese (ashensore, shkalle levizese, transportues), punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese, ndertime parafabrikate beton arme, struktura metal ike dhe druri, impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndricuese, barriera dhe mbrojtje rrugore, impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit, impiante dhe linja telefonike dhe telekomukacioni, impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj., ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij, ndertimi i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane, sistemet kundra zhurmes dhe infrastruktures. - Realizimi i veprave publike dhe private, si ne vijim: ndertimi dhe mirembajtja e strukturave spitalore, punime ne struktura detare, portuale dhe lumore, punime rikuperimi dhe restaurimi, konsolidimi dhe mbrojtjeje te territorit, punime ne impiantet e furnizimit me gaz metan, gazsjellesish, vajsjellesish, ujesjellesish, impiantesh hidroelektrike, pyjore dhe vepra ujitjeje dhe evakuimi, ndertimi i impianteve teknologjike ne pergjithesi, ndertimi i impianteve per pastrimin e ujerave te ndotura nga perdorime te meparshme. Prodhimi dhe shitja, qofte me shumice, qofte me pakice, e konglomerateve te cimentos dhe atyre bituminoze. Shfrytezimi i gurove dhe i minierave te cdo lloji. Veprimtari autotransporti edhe per llogari te te treteve. Punime topogjeodezike. Shpime gjeologo-inxhinierike, shpime puse per uje, shpime puse per naftes. Shoqeria do te mundet te promovoje themelimin ose marrjen qofte te drejtperdrejte, qofte jo te drejtpedrejte, te pjesemarrjeve ne fitime, te kuotave ose te pjesemarrjeve ne ndermarrje te tjera, shoqerive, konsorciumeve dhe enteve ne pergjithesi, te gjitha keto ne menyre instrumentale dhe ne mase jo mbizoteruese kundrejt veprimtarive te tjera qe perbejne objektin shoqeror. Shoqeria do te munde, gjithashtu, te kryeje te gjitha veprimtarite e nevojshme ose te dobishme per permbushjen e qellimeve shoqerore, nder te cilat operacione te paluajtshme, te luajtshme, industriale, tregtare dhe financiare, duke perfshire ketu edhe dhenien e garancive reale dhe / ose personale, te leshuara ne interesin e shoqerise per obligacionet qofte te vetat, qofte te te treteve. Te gjitha keto veprimtari duhet te zhvillohen brenda kufijve dhe duke respektuar normat qe rregullojne ushrimin, si edhe duke respektuar legjislacionin ne fushen e veprimtarive qe u rezervohen te regjistruarve ne Kolegje, Urdhra ose Regjistra profesionale, Ne menyre te vecante, veprimtarite me natyre financiare duhet te zhvillohen ne perputhje me ligjet ne fuqi ne kete fushe. Bar Kafe, Restorant, Furre Buke. Fastfood, etj. Ekspert Vlesimi i pasurive te paluajtshme. Ekspert vleresimi i ndikimit ne mjedis. Ekspert privat Zjarrfikes.

## **Neni 7**

### **Kapitali**

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqindë mijë) Lekë i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të dy ortakët.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1- Ortaku themelues Roland Hysa: Zotërues i 1 kuote me vlerë nominale të përgjithshme 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) Leke që përbën 51% të kapitalit.

1- Ortaku themelues Elona Boce: Zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 49.000 (dyzetë e nëntë mijë) Leke që përbën 49% të kapitalit.

## **Neni 8**

### **Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit**

- Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **Neni 9**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë
- shitblerjes
- trashëgimisë
- dhurimit
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj

## **Neni 10**

### **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) ndryshimin e statutit;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën c dhe d të kësaj pike;
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara në ligj apo statut;

Ortakët mund të përfaqësohen në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme e cila përfshinë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Administrimi**

1-Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2-Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimeve të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3-Drejtuesi teknik i shoqërisë do të jete inxhinier ndërtimi. Drejtuesi teknik i shoqërisë do të jetë dhe administrator i shoqërise

4-Znj. Elona Boce do të emërohet si Administratore e shoqërisë me një afat 5-vjecar me të drejtë ripërteritje deri në emërimin nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

## **Neni 12**

### **Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërasin Asamblenë ë Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivët e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 13**

### **Përgjegjësia e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17, e 18 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen me ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personal me ata të shoqërisë.

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit "për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **Neni 14 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

## **Neni 15 Prishja dhe Likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për tre vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr. 9723 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

e) me vendim të gjykatës

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30-ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të cakatur një likuidues.

**Neni 16**  
**Riorganizimi i Shoqërisë, Bashkimi-Ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**Neni 17**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodi Civil dhe çfarëdo ligj tjetër specifik i Republikës së Shqipërisë.

**Neni 18**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statut-akt themelimi si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndis Shoqërsë dhe të tretëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

*Ky statut-akt themelimi u hartua ne 3 (tre) kopje origjinale secili me vlere te njejte ligjore.*

**ORTAKËT THEMELUES**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“2L NDERTIM” SH.P.K**

ROLAND HYSA

Roland Hysa

ELONA BOCE

Elona Boce